

VENDIM
Nr.468, datë 16.6.2010

PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE TRUALL, PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK DHE KOMPENSIMIN E KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE, DIOQEZA KORÇË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1532, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të neneve 16 e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja, truall, pronë shtetërore, prej 2200 (dy mijë e dyqind) m², e ndodhur në zonën kadastrale 8562, e përbërë nga prona me numër pasurie 2/551, si dhe pjesërisht prona me numër pasurie 2/863, në të njëjtën zonë kadastrale, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kalojë në fondin e kompensimit fizik dhe t’i vihet në dispozicion Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit, për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e Kishës Ortodokse Autoqefale, dioqeza Korçë, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.1532, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me numër rendor 885.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra Qendrore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN RILEVIMI

PERGATITI EMRI Inspektoria e AKKP-se Ing. Bukurie KOKOSHI Licensa _____ Date _____ Data e Pregatitjes 30.03.2010 Vule - Firmë 		IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8562 NR. I PASURISE _____ VOL _____ FQ. _____ INDEKSI I HARTES KO, N-9 SHKALLA 1 : 500 ADRESA E PASURISE Rrethi _____ Korçe Q/F Korçe _____ Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____ PRONARI I pretenduar per kompensim fizik _____ Kisha Orthodhokse Autoqefale Dhioqeza Korçe S=2200m ²	
--	--	---	--

☐ Konturi i prones se pretenduar per kompensim fizik me S=2200m² i hedhur sipas plan vendosjes se pergatitur nga top. i licensuar Robert P
 Prona qe pretendohet te kompensohet eshte pozicionuar ne harten e vleres ne Zonen I



PLAN RILEVIMI

PERGATITI EMRI Inspektoria e AKKP-se Ing. Bukurie KOKOSHI Licensa _____ Date _____ Data e Pregatijes <u>30.03.2010</u> Vule - Fime	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8651 NR. I PASURISE _____ VOL _____ FQ _____ INDEKSI I HARTES KO. L-8 SHKALLA 1 : 1000 ADRESA E PASURISE Rrethi _____ Korçe _____ Q/F Korçe _____ Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____ PRONARI Kisha Ortodhokse Autoqefale Dhioqeza Korçe
--	---

- ☐ Konturi i prones se njohur me Vendim te KKP-se Korçe nr. 1329, dt.11.01.1996
- ☐ Konturi i prones se kthyer me Vendim te KKP-se Korçe nr. 1329, dt.11.01.1996 dhe me vendim gjykate nr. 1956, dt. 16.11.

Konturi i prones qe do te kompensohet.

Prona e njohur eshte e pozicionuar ne dy zona te hartes se vleres

Zona 1 dhe Zona 2

Prona qe kerkohet te kompensohet rezulton ne harten e vleres ne Zonen 1

